

VARRIMI I FEMIJEVE

TRISAIA NG SHTEPËNG E TË VDEKURIT

Kur vdes nonjë femije nene shtate vjete, Prifti shkon ne shtepin' e te vdekurit, e ve Petrahilin, temjanis, dhe bekón:

DHJAKU: Bekó, o Ate.

PRIFTI: I bekuar eshte Perendia yne, gjithenjë, taní e perhere dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín.

KENDONJESI: Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (3 here).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jeteve. Amín.

Triní e treshenjte, meshirona; o Zot, hiresoji

mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhesite tona; o i Shenjte, veshtroji, dhe sheroji semundjet tona per emrin tent. Meshiró, o Zot (3 here).

Ati yne, qe je ne qell, u-shenjterofte emri yt; arthte Mbretëria jote; u-befte deshira jote si ne qell edhe mi dhé; buken tone te perdíçime épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua falim fajtóreve tane; edhe mos na shtjer ne ngasje, po shpetona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja eshte Mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

Pastáj thuhet Litanía e Prehjes:

DHJAKU: Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe per prehjen e femijes se jetenderruar (aksh).

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Qe ta vendose Zoti Perendí shpirtin e tij atjé, ku prehen te drejtet, edhe ta vleresonje per Mbretërin' e qejve, Krishtit, Perendise dhe Mbretit tone te pavdekur, le ti lypim.

KORI: Fal-i, o Zot.

DHJAKU: Le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: O Zoti Jesú Krisht, o Perendia yne, qe ke thene: "Lérini femijet te vijne tek une, se e

atyre eshte Mbretëri' e qejve;" ti, o Zot, prit-e shpirtin e femijes se jetenderruar (aksh), dhe preh-e ne Parajsen e Mbretërise sate, atjé ku prehen te gjithë Shenjtoret e tu.

Se ti je ngjallja, jeta dhe prehja e femijes se jetenderruar (aksh), o Krisht, o Perendia yne, dhe ty te dergojme lavdí, bashke me Atin e panisme dhe me Shpirtin e tereshenjte dhe te mire dhe jetberes, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perendia yne, lavdí me ty.

KORI: Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín. Meshiró, o Zot (3 here). Bekó, o Ate.

PRIFTI: Krishti, Perendia yne i vertete, qe ungjall se vdékuresh, me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithë Shenjtóreve, e vendoste shpirtin e femijes se jetenderruar (aksh) ne Parajsen e Mbretërise qellore, e prehte ne gjirin e Abraha-mit, dhe e nmerofte bashke me Shenjtoret si i mire dhe njeridashes.

KORI: Amín.

PRIFTI: I perjetshim kujtimi yt, o femíj' e lumur dhe e perkujtuar (3 here).

KORI: I perjetshim kujtimi (3 here).

SHGRBESA FUNERALE NG KISHË

Pastáj e shpien lipsanin ne Kishë, dyke shkuar Prifti me Temjanicen perpara, dhe dyke kenduar Trishenjtin:

Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona.

Passi hyjne ne Kishe, e vendosin lipsanin perpara Deres se Bukur, dhe menjehere kendohet Kanuni Funerál i Femíjeve me ketó Zbritesore me T. T. IV pas "Igrán Dhiodhefsas":

I: O Fjale qellore o Zoti Krisht, qe linde si foshnje, ne shpergínj me trup njerezór, ti e preh ne gji te Abrahamit, keté femije qe more prej nesh o Zot.

III: Ti o Fjal' e mbaruar, foshnj' e shenjt' e qéllshime, na e more sot keté foshnje, per vete lart ne qell; preh-e te lútemi, ne qell me gjithë Shenjtoret, ne Parajsen lumcrisht, ti njeridáshesi.

IV: Per femijet mos mbani zi; po per veten tuaj qani e pendóhuni, se mekata beni gjithenjé, lútuni nga Ferri te shpetóheni.

V: Pas gjykimit te drejte, para se te rritet e kore o Zot i math, si lendine te njome, keté foshnje te vogel qe more sot; po ti o Fjale shpjer-e, dhe mbill-e ne Parajsen tende, midís lúleve dhe gjelberímeve.

VI: Ne grazhd o Krisht, si nje foshnje u-vure, dhe ne krahet e nje plaku u-mbajte, ti qe krijón gjithë foshnjat e botes, dhe pa arrire te rriten i merr o Zot, ne jeten tjater qe s' ka funt; perhirójm' e therrresim lavdí me ty.

VII: Shkrúaje foshnjen e bekuar, njeridashes ne tefterin e shpetimit, qe te cpalle me gezím, ku-

dó meshiren tende: Se i bekuar je o Zot, Perendí per gjithë jetet.

VIII: Ta prehte shpirtin Zoti Krisht, ne Parajsen e Engjcejve, ku ka gjithenjé gezím, defrím e kremterím, ne kopshtin e lúleve, me shadervanin mistík qe derth, jet' e gas pa funt, edhe ne gji t' Abrahamit, qe te therréc pa heshtur: Prifterínj e kendoni, o popuj lavderoni, per dite dhe per jete.

IX: O Krisht qe foshnjerove posi njerí, dhe mi Kryq u-mbertheve vullnetarisht, ti qe e pé, sa te qau Nena jote mi dhé; ngushelloji prínderit, per keté mjerím dhe plage dhe helm, per foshnjen qe ka vdekur, ballsám u fal per zemrat, ep-u durím o Zot o Perendí.

Pastáj kendohet Shkurtorja dhe Shtepia e Prehjes ne T. T. IV:

Me gjithë Shenjtoret, o Zoti Krisht e preh, shpirtin e besnikut tent, atjé ku s' ka as dhembje, as helme, as psherctím, po vetem jete te pambaruar.

Ti i vetem o Zot i pavdekur je, ti qe bere natyren dhe njerezit; dhe sikunder prej dheut krijóhemi, gjithashtú nene dhé do te kthéhem, sikunder urdherove ti o Zot, dyke thene: Dhé ke qene, dhe ne dhene po kthehesh, se atjé do te shkojme né njerezit, dyke thirrur me lot e me vaj qe te gjithë: Alilluja.

Pastáj thuhet Apostulli dhe Ungjilli:

DHJAKU: Le të vëmë re.

KENDONJESI: Qoftë e lumur udha, ku po ecen sot, se të është përgatitur vendi i prehjes. Ty po të therrës, o Zot, o Perendia im.

DHJAKU: Urtesí.

KENDONJESI: Kendimi prej Letres së Palit për Romanet.

DHJAKU: Le të vëmë re.

KENDONJESI: Vellezër, e dini se Krishti, pasi u-ngjall se vdekuresh, nuk vdes më, dhe vdekja nuk e zotëron më. Se kur vdiq një herë, vdiq për mekatin, po tani që rron, po rron me Perendinë. Ashtu edhe ju e nëmeroni veten tuaj të vdekur nga mekati dhe të gjallë nga Perendia me Jesú Krishtin, Zotin tonë.

KORI: Alilluja, alilluja, alilluja.

DHJAKU: Urtesí, o të drejte. Le ta degjojmë Ungjillin e Shenjtë.

PRIFTI: Paqe të gjithëve.

KORI: Dhe me frymen tënde.

PRIFTI: Kendimi prej Ungjillit të Shenjtë pas Markut.

DHJAKU: Le të vëmë re.

KORI: Lavdí, me ty, o Zot, lavdí me ty.

PRIFTI: Me atë kohë, i prunë Jesújt disa femije, që ti bekonte; dhe Dishépujt' e tij i qortuan atá, që i prunë femijet. Po kur i pá Jesuj, u-zemërua, dhe u tha: "Lérini femijet të vijne tek unë, dhe mos i ndaloni, se e atyre është Mbretëri' e Pe-

rendisë. Me të vertetë po ju thom se aý, që nuk e pret Mbretëri' e Perëndisë si një femije, nukë do të hynjë atjë brenda." Dhe i mori në krahet, u vu-ri dorën mi koke, dhe i bekóji.

KORI: Lavdí, me ty, o Zot, lavdí me ty.

Pastáj behet Litania e Prehjes:

DHJAKU: Meshirona, o Perëndí, pas meshirës sate së madhe, të lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe për prehjen e femijes së jetenderruar (*aqsh*).

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Që ta vendosë Zoti Perëndí shpirtin e tij atjë, ku prehen të drejtet, edhe ta vlerësonjë për Mbretëri' e qejve, Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë të pavdekur, le të lypim.

KORI: Fal-i, o Zot.

DHJAKU: Le të lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: O Zoti Jesú Krisht, o Perendia ynë, që ke thënë: "Lérini femijet të vijne tek unë, se e atyre është Mbretëri' e qejve;" ti, o Zot, pritë shpirtin e femijes së jetenderruar (*aqsh*), dhe preh-e në Parajsën e Mbretërisë sate, atjë ku prehen të gjithë Shenjtoret e tu.

Se ti je ngjallja, jeta dhe prehja e femijes së jetenderruar (*aqsh*), o Krisht, o Perendia ynë, dhe ty të dergojmë lavdí, bashkë me Atin e panismë dhe me Shpirtin e tërëshenjtë dhe të mirë dhe je-

teberes, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

Pastáj thuhën ketó Tropare te Pershendoshjes ne Tingellin Terthór I pas "O tu paradoksu."

Cili nuke qan per ty me lot, dhe cili nuke vajtón, qe na mbyte keshtú me zi; se na ike me nxitím, nga peqiri i nenes sot, na fluturove, befas posi bilbil, dhe prane Zotit, vajte me vrap ne qell; o shpirt ku esht ay, qe s' vajtón kur po shikón si tu venít, si tu verth fytýreza, e bukur si trendafil.

Cili s' psheretín me vaj taní, dhe cili nuke mban zi, per fytyren prej Engjelli, dhe jeten e ndrícime, pa nje faj e pa nje mekát. Se si anie, humbe dhe gjyrme s' lé, ashtú u-çduke, nga syt' e mi taní. Eni o miqt' e mi, o gjirinj e t' áferme me mua tok, eni pershendósheni, ne varr percílleni.

Vdekja eshte prehje per ketá; se te keqiat mi dhé, s' kane force ti vúajne, se nuk i durojne dot, perandáj shkojne lart ne qell, pran' Abrahamit, prane Shenjtóreve, dhe ne Parajse, gjejne defrím e gas, bashke me Engjecjte, dhe kecejne shoqerísht me brohorí, se nga jeta plot me zi, shpetuan pa mundím.

LAVDI, T. T. II: I dolli e hidhur Adamit, pema qe hengri qemoti ne Parajse, se piu helmin e gjárperit; se nga kjo na rodhi vdekja, qe e há njerine ploterísht; po ardhi Zoti, e dermój kuçedren, dhe na fali prehjen. Atí le ti therresim: Ndjeje o Zot

até qe na more, dhe preh-e me Shenjtoret si njeridashes.

TANI: O Virgjereshe Hyjlíndese, gezím i te helmúarve, sherím i te semúreve, paqa e te leftúarve, limán i dimerónjcsve, e vétcmja mprójtese e besníkeve, shpctoje qytetin edhe pópullin.

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perendia yne, lavdí me ty.

KORI: Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín. Meshiró, o Zot (3 here). Bekó, o Ate.

PRIFTI: Krishti, Perendia yne i vertete, qe ungjall se vdékuresh, me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithë Shenjtóreve, e vendoste shpirtin e femijes se jetenderruar (aksh) ne Parajsen e Mbretetise qellore, e prehte ne gjirin e Abrahamit, dhe e nemerofte bashke me Shenjtoret si i mire dhe njeridashes.

KORI: Amín.

PRIFTI: I perjetshim kujtimi yt, o femíj' e lumur dhe e perkujtuar (3 here).

KORI: I perjetshim kujtimi (3 here).

Pastáj e shpien lipsanin ne varret, dyke kenduar Trishenjtin:

Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona.

SHCRBESA NE VARRET

Posa arrijne ne varret, Prifti e ve Petrahilin, temjanís, dhe bekón:

DHJAKU: Bekó, o Ate.

PRIFTI: I bekuar është Perendia yne, gjithënjë, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amín.

KENDONJESI: Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (3 here).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jéteve. Amín.

Triní e tërshenjtc, meshirona; o Zot, hirësoji mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhësitë tona; o i Shenjtë, veshtroji, dhe sheroji semundjet tona për emrin tënt. Meshiró, o Zot (3 here).

Ati yne, që je në qell, u-shenjtcroftë emri yt; arthtc Mbretëria jote; u-bëftë dëshira jote si në qell edhe mi dhé; buken tëntë të përdíçime épnaje nëve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua falim fajtoëve tëntë; edhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja është Mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amín.

Pastáj thuhet Lítania e Prahjes:

DHJAKU: Meshirona, o Perendí, pas meshirës sate se madhe, të lútemi, dëgjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe për prahjen e femijës se jetenderruar (aksh).

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Që ta vendosë Zoti Perendí shpirtin

e tij atjé, ku përehen të drejtë, edhe ta vlerësonjë për Mbretërin' e qëjve, Krishtit, Perendisë dhe Mbretit tëntë të pavdekur, le të lypim.

KORI: Fal-i, o Zot.

DHJAKU: Le të lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: O Zoti Jesú Krisht, o Perendia yne, që ke thënë: "Lérini femijet e vegjel të vijne tek unë, se e atyre është Mbretëri' e qëjve;" ti, o Zot, prit-e shpirtin e femijës se jetenderruar (aksh), dhe përh-e në Parajsën e Mbretërisë sate, atjé ku përehen të gjithë Shenjtoret e tu.

Se ti je ngjallja, jeta dhe përhja e femijës se jetenderruar (aksh), o Krisht, o Perendia yne, dhe ty të dërgojmë lavdí, bashkë me Atin e panishtë dhe me Shpirtin e tërshenjtc dhe të mirë dhe jetëberës, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perendia yne, lavdí me ty.

KORI: Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jéteve. Amín. Meshiró, o Zot (3 here). Bekó, o Atë.

PRIFTI: Krishti, Perendia yne i vërtetë, që unëgjall se vdekuresh, me nermjetimet e Shen Marisë dhe të gjithë Shenjtóëve, e vendosë shpirtin e femijës se jetenderruar (aksh) në Parajsën e Mbretërisë qëllorë, e përhë në gjirin e Abrahámit, dhe e nermroftë bashkë me Shenjtoret si i mirë dhe njeridashes.

KORI: Amín.

PRIFTI: I perjetshim kujtimi yt, o femíj' e lumur dhe e perkujtuar (3 here).

KORI: I perjetshim kujtimi (3 here).

Perpara se te vihet lipsani ne varr, Prifti merr me lopaten ca dhé, e heth mi lipsanin kryqthi, dhe thote:

PRIFTI: Zoti e ka dhene dhe plotesín' e tij, boten e tere dhe gjithë banoret e saj.

Pastáj Prifti derth mi lipsanin kryqthi vaj e vere, ose hi te Temjanices.

Ne Pershpirtet kendohet gjithashtú Lítania, Urata dhe Perleshimi i Femíjeve, dyke thene ne krye vetem Shkurtoren e Prehjes pa nonjë kendím tjater.